



REPUBLIKA E SHQIPËRI  
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201701752/5

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2018

**Lënda:** *Rekomandojmë marrjen e masave për realizimin e përshtatshmërisë së rampës në hyrjen kryesore të Spitalit Rajonal Shkodër*

**Drejtuar:** **Z. Vilson MASMALAJ**  
**Drejtor i Spitalit Rajonal**

**SHKODËR**

***I nderuar zoti Masmalaj,***

Siç jeni në dijeni, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi S.U, në përmbajtjen e së cilës ankohet për rampën e vendosur në hyrje të Spitalit Rajonal Shkodër.

Sipas shpjegimeve të tij, ankuesi gëzon statusin e invalidit para dhe tetraplegjik dhe është anëtar i Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Shkodër. Në emër të kësaj shoqate, ai shpreh shqetësimin lidhur me vendosjen e rampës në hyrjen kryesore të këtij institucioni, pasi rampa e vendosur për të lehtësuar lëvizjet e tyre, hyrje - dalje në spital, është jashtë çdo parametri ndërtimi për këtë kategori të personave me aftësi të kufizuara. Për shkak të pjerrësisë së rampës, ato duhet të jenë domosdoshmërisht të shoqëruar nga ndihmësa për të shtyrë karrocën në ngjitje dhe për të mbajtur frenat gjatë zbritjes. Ka paraqitur ankesë dhe ka marrë përgjigje se rampa është bërë konform rregullave teknike. Pretendimi i tij konsiston në faktin se rampa nuk është ndërtuar si përshtatshmëri infrastrukurore për ta, por është shumë e pjerrët që e bën të pamundur lëvizshmërinë e tyre vetëm pa ndihmën e të tjerëve. Duke e konsideruar këtë çështje si shkelje të të drejtave të tij ligjore, ka kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit.

Për shqyrtimin e kësaj ankese, me shkresën tonë nr. K1/SH4-2 datë 09.01.2018, ju kemi drejtuar për të na informuar nëse qëndronte pretendimi i shtetasit Sajmir Ustabeqiri për mosndërtimin e rampës konform rregullave teknike të përshtatura

*për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara që lëvizin me karrocë. Gjithashtu të na sqaronit nëse nga ana juaj ishte marrë ekspert përkatës për të përcaktuar rregullat teknike për ndërtimin e rampës dhe nëse dispononit dokumentacion, të na dërgonit kopje e saj.*

Në përgjigje të kërkesës sonë na keni kthyer përgjigje si më poshtë:

*“Në Spitalin Rajonal Shkodër ka disa rampa, të cilat janë në shërbim të personave me aftësi të kufizuara dhe janë brenda të gjithë kushteve teknike, të cilat i shpërbejnë të gjithë personave që lëvizin me karrocë brenda gjithë godinës së Spitalit Rajonal Shkodër:*

- Përballë godinës së vjetër të Psikiatrikut (konform rregullave teknike)*
- Në godinën e Maternitetit (konform rregullave teknike)*
- Në hyrje të Shërbimit të Imzherisë (konform rregullave teknike)*
- Në hyrje të Urgjencës (konform rregullave teknike)*
- Në hyrjen kryesore (**ka pjerrësi më të madhe**).*

Pra, siç shihet, qëndrojnë pretendimet e ankuesit, se rampa në hyrjen kryesore të Spitalit Rajonal Shkodër, ka pjerrësi më të madhe dhe nuk është e përshtatshme për lëvizjen e personave që lëvizin me karroca.

Pavarësisht realizimit të përshtatmërisë ndërtimore në godinat e sipërcituara, konform rregullave teknike, nuk është realizuar plotësisht kjo përshtatmëri në hyrjen kryesore të Spitalit. Pjerrësia duket qartasi edhe nga pamja e saj sipas fotos bashkangjitur.

Bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara*”, Avokati i Popullit është një institucion monitorues për zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën e OKB-së “*Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*”.

Personat me aftësi të kufizuara: invalidët paraplegjikë&tetraplegjikë dhe të verbërit, e kanë të pamundur që të lëvizin në mënyrë të pavarur për të marrin të gjitha shërbimet. Ndërtesat publike dhe private duhet të jenë të aksesueshme për këto kategori personash, me qëllim që të mos cënohen të drejtat e tyre dhe të ndihen të barabartë me pjesën tjetër të popullsisë.

–Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut, në nenin 1 ka përcaktuar se: “*Të gjithë njerëzit janë të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta*”

-Qëllimi i Konventës së OKB-së “*Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*”, është që të nxisë, të mbrojë dhe të sigurohet, që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

*Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë individët me dëmtive fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjatë, të cilat në ndërveprimin me barriera rëndësishme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri, si pjesa tjetër e popullsisë.*

-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 59 të saj, ka përcaktuar se:

“ Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

...d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;

- e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;
- f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paafteve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës;

-Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, ka për qëllim:

- të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes;
- të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri.

-Vendimi nr 1074 datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjahen pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Sipas pikës 4 të Kreut I, ky vendim e shtrin zbatimin mbi:

- a) bashkitë dhe strukturat e tyre të kontrollit, sipërmarrësit privatë, administratorët e bizneseve, kompanitë e projektimit e të zbatimit të projekteve ndërtimore, si dhe të gjitha subjektet përgjegjëse për të garantuar një mjedis pa pengesa për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara;
- b) të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore të reja dhe ekzistuese, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kryesisht objektet e shëndetit publik, banesat dhe objektet rezidenciale, shkollat dhe institucionet shkencore, objektet kulturore, objektet e kultit, qendrat tregtare, institucionet administrative e të shërbimit publik, ndërmarrjet e qendrat e punës, në mjediset e të cilave ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët...”

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, si dhe në bazë të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”:

## **REKOMANDOJMË:**

*Marrjen e masave për realizimin e përshtatshmërisë së rampës të vendosur në hyrjen kryesore të Spitalit Rajonal Shkodër.*

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se;

*“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet t’a shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ”,*

Lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin Tuaj të deritanishëm, mbetemi në pritje të përgjigjes,

**K O M I S I O N E R I**

**Ermir KAPEDANI**